



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TE PERQENDRUARA

Tiranë, me 05.03.2019

SQARIM

Organi Qendror Blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në datën 19.02.2019 ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedurën e prokurimit “Tender i Hapur” me objekt **“Blerje uniforma verore për Policinë e Shtetit” - Marrëveshje kuadër**, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjeve kuadër 1 (një) vit, Fondi limit i marrëveshjes kuadër: **150,013,333 (njëqind e pesëdhjetë milion e trembëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

Në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Organi Qendror Blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, sqaron të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar:

1. Në lidhje me pikën 2, të Kapaciteti ligjor/profesional të operatorëve ekonomikë, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DT ku përcaktohet se:

*“1.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 9001** (të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.*

*2.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 14001** (të vlefshme) të sistemit të menaxhimit të mjedisit. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet..*

*3.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë **OHSAS -18001** (të vlefshme) për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në punë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.”*

Sqarojmë se vetë kriteri përcakton që certifikatat ISO 9001, ISO 14001 dhe OHSAS 18001, duhet të jenë të vlefshme në momentin e zhvillimit të procedurës. Në mbështetje të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 30 “Kërkesat e cilësisë”, sqarojmë se të gjitha certifikatat e kërkuara janë në përpjesëtim, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, si dhe me qëllim vërtetimin se ofertuesit (operatorët ekonomikë) që ofrojnë mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë.

Gjithashtu, bazuar në nenin 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas elementeve konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis operatorëve ekonomikë.

2. Në lidhje me pikën 3.2 të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” në Kriteret e Veçanta të

Kualifikimit të DT, ku përcaktohet se:

“3.2 Operatori ekonomik duhet të provojë disponueshmërinë me të gjitha format e njohura nga legjislacioni përkatës në fuqi se disponon minimalisht 2 (dy) nga linjat e prodhimit me makineritë përkatëse të nevojshme për realizimin e artikujve, objekt i kësaj kontrate.

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë nga operatori ekonomik ku të deklarohen linjat e prodhimit në përputhje me objektin e kontratës dhe

- Deklaratë për makineritë sipas këtyre linjave dhe numrat seriale të tyre.

Për makineritë dhe pajisjet e deklaruar sipas kësaj pikë të provohet disponueshmëria e tyre në një nga mënyrat sipas legjislacionit në fuqi si më poshtë:

- fatura shit- blerje ose

- kontrata shit- blerje ose

- kontratë qeraje ose

- kontratë huapërdorje ose

- të jenë të pasqyruara në bilancin e vitit 2017.

Në rastin e bashkimit të operatorëve, dokumentat që duhet të paraqiten duhet të jenë në përputhje me përqindjen e punëve apo shërbimeve si dhe natyrës së shërbimit që do të kryejnë këta operatorë.”

Sqarojmë se operatorët ekonomik duhet të provojnë se disponojnë minimalisht 2 linja prodhimi, kapacitet teknik i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Për shkak të avancimit teknologjik të makinerive të cilat janë pjesë e linjave të prodhimit, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë përcaktuar llojet, tipet, modelet konkrete të makinerive, por është lënë mundësia për të gjithë operatorët ekonomik që nëpërmjet vet deklarimit të paraqesin situatën reale të disponimit minimalisht të dy linjave të prodhimit dhe makinerive përkatëse me numrat serial. Gjithashtu, disponimi i makinerive të vet deklaruar duhet të provohet nëpërmjet dokumentacionit të përcaktuar në këtë kriter.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

3. Në lidhje me pikën 4 “Kapaciteti njerëzor” të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit shtojca 9 në DST, ku përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik specialistë të fushës në pozicionet e punës:

- inxhinier tekstili, të paktën një punonjës

- modelist, të paktën një punonjës

- përgjegjës prodhimi/linje, të paktën një punonjës

- prestarë, të paktën një punonjës

- kontrollorë cilësie, të paktën një punonjës

➤ Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin teknik,

- një listë të personelit kryesor teknik të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

- CV.

- Kopje të diplomave apo të dëshmimeve të aftësive profesionale nëse i zotërojnë.

- Në mungesë të një diplome/certifikate, do të merret parasysh kualifikimi për shkak të eksperiencës.

- Listëpagesë të deklaruar në organet tatimore për periudhën Qershor 2018 - Janar 2019 (Formulari numër E-SIG 025/a.1 ose Ekuivalente me të për operatorët e huaj)

- Kopje të librezës së punës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve, dokumentat që duhet të paraqiten duhet të jenë në përputhje me përqindjen e punëve apo shërbimeve si dhe natyrës së shërbimit që do të kryejnë këta operatorë.”

Për dokumentin **”kopje e librezave të punës”** të kërkuar në DT, sqarojmë për secilin nga rastet e mundshme të ofertimit, nga operator ekonomik shqiptar ose të huaj, si vijon:

- Nëse operatori ekonomik është vendas (shqiptar), duhet të paraqesë për stafin teknik, kopje të librezave të punës;
- Nëse operatori ekonomik është i huaj, duhet të paraqesë për stafin teknik, kopje të librezave të punës ose ekuivalente me to nëse ekzistojnë, sipas dispozitave të ligjit vendas të tij;
- Nëse ligji vendas i operatorit ekonomik të huaj nuk parashikon paisjen me librezë pune ose ekuivalente me të, operatori ekonomik i huaj duhet të vetëdeklarojë për secilin punonjës të stafit teknik eksperiencën sipas pozicionit të punës.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.

4. Në lidhje me pikën 4 “Kapaciteti njerëzor” të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit shtojca 9 në DST, ku përcaktohet se:

“Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik specialistë të fushës në pozicionet e punës:

- **inxhinier tekstili, të paktën një punonjës**
- *modelist, të paktën një punonjës*
- *përgjegjës prodhimi/linje, të paktën një punonjës*
- *prestarë, të paktën një punonjës*
- *kontrollorë cilësie, të paktën një punonjës*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin teknik,*
 - *një listë të personelit kryesor teknik të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.*
 - *CV.*
 - *Kopje të diplomave apo të dëshmive të aftësive profesionale nëse i zotërojnë.*
 - *Në mungesë të një diplome/certifikate, do të merret parasysh kualifikimi për shkak të eksperiencës.*
 - *Listëpagesë të deklaruar në organet tatimore për periudhën Qershor 2018 - Janar 2019 (Formulari numër E-SIG 025/a.1 ose Ekuivalente me të për operatorët e huaj)*
 - *Kopje të librezës së punës.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve, dokumentat që duhet të paraqiten duhet të jenë në përputhje me përqindjen e punëve apo shërbimeve si dhe natyrës së shërbimit që do të kryejnë këta operatorë.”

Sqarojmë se në rastin e paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomik, në marrëveshjen e noterizuar duhet të përcaktohen përqindja e pjesëmarrjes së furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kërkesa për të patur në stafin teknik të paktën një Inxhinier-Tekstil, duhet të plotësohet nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomik, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes, duke patur parasysh edhe elementet konkret që secili prej anëtarëve të këtij bashkimi merr përsipër të

realizojë. Nëse operatori ekonomik pjesë e bashkimit, merr përsipër të realizojë prodhimin e një apo më shumë artikujve, atëherë ai duhet të ketë patjetër në stafin e tij inxhinier tekstil, duke qenë se merr përsipër elementin konkret të prodhimit të artikujve. Nëse disa operatorë ekonomik pjesë e bashkimit, bien dakord në marrëveshjen e bashkëpunimit që një inxhinier tekstil i punësuar tek një prej anëtarëve të bashkimit të OE, të jetë në dispozicion të realizimit jo vetëm të përqindjes takuese të anëtarit ku është i punësuar, por edhe në dispozicion të anëtarëve të tjerë të këtij bashkimi operatorësh, të cilët kanë marrë përsipër elemente konkrete të prodhimit të artikujve, atëherë do të konsiderohet se kërkesa për pasjen e një inxhinieri tekstil, plotësohet nga i gjithë bashkimi i operatorëve.

I njëjti sqarim, në rastin e paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomik, vlen edhe për kriterin e përcaktuar në pikën 3.3 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” për sistemin CAD (software inxhinierik i fushës së modelimit të veshjeve).

5. Në lidhje me pikën 7 në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit shtojca 9 në DST, ku përcaktohet se:

“Prodhuesit e lëndëve të para duhet të jenë të pajisur me certifikatën OEKO-TEX (ose ekuivalente me të) të vlefshme ose në mungesë të certifikimit, mund të pranohen raporte testimi nga laboratorë të akredituar të cilët vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar në certifikatën OEKO TEX. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose raportet e testimit duhet të paraqiten për të gjithë prodhuesit. Referoju tabelës së mëposhtme për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar sipas pikës 6 (oferta teknike) dhe pikës 7 tek (certifikata OEKO – TEX) të kërkuar në pikën 2.3”

Sqarojmë se certifikata të vlefshme OEKO - TEX/ ose ekuivalente me të/ ose raporte testimi nga laboratorë të akredituar në mungesë të certifikimit, duhet të paraqiten për çdo prodhues/ furnitor të lëndëve të para, minimalisht vetëm për ato artikuj që janë specifikuar në tabelën në vijim të pikës 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të DT, e konkretisht për 9 nga 14 artikujt e specifikuar në tabelë. Për artikujt objekt prokurimi me nr.rendor 8, 10, 12, 13 dhe 14, në tabelën e pikës 7 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk është përcaktuar detyrimi për të paraqitur certifikatat e sipërcituara. Gjithashtu sqarojmë se rastet e paraqitjes së certifikatës së vlefshme OEKO - TEX/ ose ekuivalente me të/ ose raporte testimi nga laboratorë të akredituar në mungesë të certifikimit, edhe për artikuj të tjerë nuk përbën rast për s kualifikim.

Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose raportet e testimit duhet të paraqiten për të gjithë prodhuesit e lëndëve të para.

6. Në lidhje me pikën 4.2 të Njoftimit të Kontratës të DT, sqarojmë se kriteri i përzgjedhjes së fituesit, është mirë përcaktuar në DT, e konkretisht:

“Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Vlerësimi i ofertës/ ofertave do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi.

Çmimi më i ulët do të jetë vlera totale e të gjitha çmimeve për njësi të artikujve.

Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë do të bëhet sipas vlerës më të ulët të shumatores së çmimeve për njësi.

7. Në lidhje me Shtojcën 1 “Formulari i Ofertës ekonomike” të DT, sqarojmë se me anë të saj është pasqyruar edhe mënyra e ofertimit, sipas tabelës që përmban kolonën me përshkrimin e mallrave që do të prokurohen, kolonën me njësitë matëse për secilin artikull si dhe kolonën me çmimin për njësi, e cila nga ana e operatorëve ekonomik rrjedhimisht duhet të plotësohet për sasinë 1 (një) njësi.

Gjithashtu sqarojmë se sasi të përcaktuara në shtojcën 12 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të DT janë “sasi të pritshme”, sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë më pak apo më shumë mallra se sa ato të parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër), siç parashikohet edhe njoftimin e kontratës së DT.

Në rreshtin e fundit të kësaj tablele është përcaktuar qartësisht edhe **vlera totale si shumatore limit e çmimeve për njësi (në LEK) pa TVSH**, vlerë kjo që shërben si fond limit për operatorët ekonomik gjatë hartimit të ofertës së tyre ekonomike, e rrjedhimisht vlerë e cila nuk duhet të tejkalohet. Një shpjegim i tillë është cituar edhe në pikën 4.2 “Kriteret e Përzgjedhjes së Fituesit”, e konkretisht: *“Vlerësimi i ofertës/ofertave do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi.”*

Çmimi më i ulët do të jetë vlera totale e të gjitha çmimeve për njësi të artikujve. Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë do të bëhet sipas vlerës më të ulët të shumatores së çmimeve për njësi.”

Sa më sipër, edhe verifikimi i ofertës anomalisht të ulët do të bazohet mbi fondin limit të shumatores së çmimeve për njësi prej 55.383,³³ Lekë (pa TVSH).

8. Në lidhje me shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimit” të DT, ku përcaktohet se:

“Afati i fundit i lëvrimit të objekteve të uniformës duhet të jetë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga lidhja e kontratës. Autoriteti Kontraktor do të pranojë lëvrimin e pjesshëm të artikujve në momentin më të parë që një pjesë e tij është përfunduar. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë në momentin e lidhjes së kontratës një plan prodhimi të çdo objekti të ofertuar, duke ju referuar raportit kapacitete teknike -kapacitete njerëzore - afat lëvrimit.”

Për afatin e lëvrimit të mallrave pas lidhjes së kontratës / kontratave në bazë të marrëveshjes kuadër, sqarojmë se autoriteti kontraktor do të lidhë një ose disa kontrata sipas nevojave që ka. Afati i lëvrimit i referohet secilës prej kontratave që do të lidhen midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik fitues të marrëveshjes kuadër, brenda afatit 12 mujor të marrëveshjes kuadër.

Referuar dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar lejimin e nënkontraktimit të ekzekutimit të kontratës / kontratave, deri në masën 40% (maksimumin e lejuar sipas ligjeve në fuqi), në mënyrë që operatorët të kenë mundësinë të përfundojnë më shpejt lëvrimin e mallit. Gjithashtu, për të lehtësuar sa më shumë ekzekutimin e kontratës, autoriteti kontraktor ka parashikuar të lejojë lëvrimin e pjesshëm të mallit, në momentin më të parë që një pjesë e tij është përfunduar nga kontraktuesi/ nënkontraktuesi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

